



Pranuar / Dorezuar Prilijenat/Prodato Received/Delivery	30-05-2022	2	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHOK	3154/2022		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.391/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.391/2022 të datës 19.04.2022 të ankuesit me adresë:

të punësimit Administratës Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 30.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa me numër A.nr.391/2022 e datës 19.04.2022 e parashtruar nga ankuesi.

II. MBETET në fuqi Vendimi më numër ZQ-12-06-1060 i Divizionit të Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 16.03.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Administratës Tatimore të Kosovës kundër Vendimit me numër ZQ-12.06.1060 të Divizionit të Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 16.03.2022 ka parashtruar ankesë nëpërmjet e-maili me datë 15.04.2022 e cila në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është regjistruar me datë 19.04.2022 dhe numër protokoli:2187/2022.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës me datë me datë 26.04.2022 ka parashtruar kërkesë tek Administratës Tatimore të Kosovës e Kosovës, ndërsa të njëjtit me datë 12.05.2022 kanë përcjellë provat e nevojshme të lëndës me dokumentacionin përcjellës e cila është regjistruar me numër:2746/2022 dhe shkresës plotësuese me numër protokoli:2752/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 19.04.2022 të parashtruar në Këshillin i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, Kërkesën për punë sekondare të datës 22.10.2021; E-mailin e datës 25.10.2021 dërguar nga për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; Kërkesën për përgjigje në ankesë e dërguar nga Këshilli në ATK; Përgjigja në kërkesë e datës 12.05.2022 me numër prot:2752/2022; Përgjigja në kërkesë e datës 12.05.2022 me numër prot:2746/2022; Akt emërimit e ankuesit të datës 05.05.2017 me numër prot:02/135/09; Vendimin e datës 27.01.2021 për ri caktimin e ankuesit; Formulari për përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Menaxher Regjional; Matricën e delegimit të autorizimeve në ATK; Shkresën e quajtur instrumenti i delegimit të autorizimit të datës 11.09.2020; Vendimin e datës 16.03.2022 lëshuar nga Divizioni i Standardeve Profesionale të ATK-së; E-mailin e datës 16.03.2022 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 25.10.2021 dërguar nga për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; E-mailin e datës 22.10.2021 dërguar nga ankuesi për me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 22.10.2021 dërguar nga për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 08.03.2022 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 09.03.2022 dërguar për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; E-mailin e datës 25.10.2021 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 09.03.2022 dërguar nga ankuesi për Kërkesën për punë sekondare të ankuesit të datës 09.03.2022; Raportin e verifikimit të angazhimit në punë sekondare për zyrtarin i datës 15.03.2022 me numër reference 04/22-KI; Lisat e pagave për të punësuar/ankuesin për vitet 2014-2015-2016-2017-2018-2019-2020-2021-2022; Rregulloren e Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës e datës 03.09.2021 me numër prot:09-06-4014; Pasqyrën e tatimpaguesit sipas regjistrimit të përpunimit të të dhënave nga ATK.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit se Divizioni i Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 16.03.2022 përmes të cilit ia ka refuzuar ankuesit kërkesën për angazhimin në punë sekondare ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, tejkalim të autorizimeve ligjore, zbatim jo të drejtë dhe të gabuar të dispozitave ligjore-materiale dhe vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike.

Po ashtu, në bazë të Vendimi më numër ZQ-12-06-1060 i Divizionit të Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 16.03.2022, Kolegji ka konstatuar se kërkesa e ankuesit për punë sekondare e datës 09.03.2022 është refuzuar me arsyetimin se biznesi në të cilin ankuesi synon të angazhohet në punë sekondare hynë në zonën e përgjegjësisë së tij si dhe biznesi në fjalë ka borxhe tatimore në vazhdimësi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të aktit të emërimit të datës 05.05.2017 më numër protokolli:02/135/09 ka konstatuar se ankuesi është marrëdhënie punë në Administratën Tatimore të Kosovës-Regjioni i Ferizaj në pozitën Drejtor i Drejtorisë Rajonale-Shtylla Funksionale e Operacioneve, ndërsa përmes vendimit me numër:24 i datës 27.01.2021 të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm nga data 04.02.2021 prej pozitës Drejtor Rajonal në Drejtorinë

Rajonale Prizreni 2 ri caktohet në pozitën e njëjtë Drejtor Rajonal në Drejtorinë Rajonale Ferizaj, ndërsa bazuar në shkresat e lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi në bazë detyrimet ndaj institucionit apo vendit të punës sipas aktit të emërimit i datës 05.05.2017 i nënshkruar dhe pranuar nga ankuesi, në pikën 3-Obligimet, është i obliguar që, citoj: *“Është obligim i të punësuarit, të tregoj respekt dhe të punojë në përputhje me të gjitha ligjet e aplikueshme nga Administrata Tatimore të Kosovës, politikat, udhëzimet dhe të gjitha aktet tjera të Administratës Tatimore, të cilat janë në fuqi apo që do të hyjnë në fuqi në ta ardhmen”*, ndërsa në bazë të përshkrimit të detyrave të punës i njëjtin ndër detyra kryesore ka: *“Të koordinojë dhe monitorojë aktivitetet e mbledhjes së detyrueshme në regjion dhe të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e ligjit në mbledhjen e borxheve”*, ndërsa qëllimi vendit të punës për menaxherët regjional është si vijon: *“Menaxheri regjional menaxhon punën e stafit për realizimin e objektivave vjetore të përcaktuara nga menaxhmentin i lartë për regjione dhe siguron trajtimin e barabartë të tatimpaguesve në përputhje me kërkesat ligjore. Zyrat regjionale mundësojnë tatimpaguesve shërbime më të shpejta dhe kualitative si dhe zgjidhjen e problemeve eventuale nga stafi regjional”*.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës e datës 03.09.2021 me numër prot:09-06-4014 neni 3 paragrafi 1 nën paragrafët 1.5, 1.6 dhe 1.7 ku përcaktohet se: *“Për qëllim të kësaj Rregulloreje të brendshme termet e më poshtme kanë këtë kuptim: 1.5-Zona e përgjegjësisë: përfshinë detyrat e zyrtarit mbi lokacionin (terenin dhe ekipen) ku zyrtari është përgjegjës për të kryer aktivitetin zyrtar; 1.6-Puna sekondare: nënkupton punën dhe angazhimin që zyrtari i ATK e kryen me pagesë apo pa pagesë jashtë Administratës Tatimore të Kosovës dhe 1.7-Konflikt Interesi: rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave mbi bazën e shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë sikurse dhe në bazë të gjeturave të pasqyruara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se Divizioni i Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 16.03.2022 përmes të cilit ia ka refuzuar ankuesit kërkesën e datës 09.03.2022 për angazhimin në punë sekondare në cilësinë e ligjëruesit Kolegjin Universum, kanë vepruar në pajtueshmëri me aktet e brendshme normative të Administratës Tatimore respektivisht me nenin 7 paragrafi pika 6.3 të Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës ku përcaktohet se: *“Zyra e Standardeve Profesionale refuzon kërkesën për angazhimin në punë sekondare, në rastet kur: Angazhimi në punë sekondare bie ndesh me legjislacionin për konfliktin e interesit”* pasi që biznesi privat respektivisht në të cilën ankuesi ka ushtruar punë sekondare dhe njëkohësisht ka përsërit kërkesën për punë sekondare hynë në zonën e përgjegjësisë së tij (adresa Fan Noli nr.156, Komuna Ferizaj) dhe po ashti biznes i njëjtë sipas pasqyrës të tatimpaguesit sipas regjistrit të përpunimit të të dhënave nga ATK është e vërtetuar se ka borxhe tatimore të papaguara në vlerë prej pesëdhjetë e pesëmijë e katërqind e katërdhjetë e katër euro (55,414.05)€, andaj me këtë rast angazhimi i ankuesit në punë sekondare në në është veprim që bie në kundërshtim me nenin 7 paragrafi të Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës ku përcaktohet se: *“Zyrtari i ATK mund të angazhohet në punë sekondare në lëmitë si: ...mësimdhënie... Këto aktivitete mund të ushtrohen nga zyrtari i ATK, nëse nuk ka konflikt të interesit apo nëse aktiviteti nuk është i ndaluar me dispozita tjera ligjore”*.

Lidhur me pretendimet e palës ankuese se i njëjti kërkesën e përsëritur për punë sekondare të datës 09.03.2022 e ka bërë edhe me datë 25.10.2021 mirëpo nuk ka marr përgjigje nga ana e Divizionit të Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës, nuk mund të shqyrtohen nga Këshilli pasi që ka kaluar afati për heshtje administrative të përcaktuar si me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, ndërsa ankesa e ankuesit është shqyrtuar vetëm mbi bazën e pretendimeve ankimore të ankuesit kundër aktit administrativ respektivisht kundër vendimit të datës 16.03.2022 më numër ZQ-12-06-1060 i Divizionit të Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës përmes ankesës së datës 19.04.2022 të parashtruar në Këshill.

Kolegji thekson faktin se me rastin e nxjerrje vendimit të datës 16.03.2022 më numër ZQ-12-06-1060 Divizioni i Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës duke ia refuzuar ankuesit kërkesën për punë sekondarë kanë zbatuar aktet e brendshme të Administratës Tatimore të Kosovës të cilat ankuesi i ka pranuar me rastin e nënshkrimit të aktit të emërimit të datës 5.05.2017 më numër protokolli:02/135/09, ndërsa në asnjë rrethane nuk i ka cenuar të drejtat e ankuesit që burojnë nga neni 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*, ndërsa nëpunësit civil duhet ta kenë parasysh se me rastin e ushtrimit të detyrave të tij të punës duhet të veprojë në pajtueshmëri me detyrimet që rrjedhin nga neni 29 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"1. Zyrtari publik ka detyrimin të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në pajtim me ligjin. 2. Zyrtari publik ka detyrimin të informojë pa vonesë mbikëqyrësin e tij, në rast dyshimi për një konflikt interesi dhe të zbatojë urdhrat e institucionit për parandalimin e konfliktit të interesit"*, ndërsa Kolegji e thekson faktin se që nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 është i zbatueshëm Ligji Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ndërsa sipas nenit 85 të të njëjtit është shfuqizuar Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A.nr.391/2022

**Flakron Gashi**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Divizionit të Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivoit të KPMSHCK-së.

